




TË ZHVLRËSOHET STRATEGJIA DHE TË PËRAFROHEN EGJIPTIANËT DHE ASHKALITË



Veton Berisha

**Egjiptianët kosovar dhe
Kushtetuta e Republikës
së Kosovës**



**Kryesia e IRDK-së përshëndet
arritjen e marrëveshjes për
normalizimin e marrëdhënieve
në mes të Kosovës dhe Serbisë**



Dr. Rubin Zemon

**Historia e Egjiptianëve të
Ballkanit**



“Mision i pamundshëm?”

Fazli Stollaj

Mision i pa mundshëm" ose si "Trik politik" ishte kuptuar inicimi i bisedave të komunitetit të ndarë në egjiptian dhe ashkali. Perceptimi se përafrimi dhe unifikimi i komunitetit tonë të ndarë është "mision i pa mundshëm" gjënë arsye të dominojë te ata që janë të pa kënaqur me përfaqësuesit e tyre politik, te ata që ishin akter të ndarjes dhe te ata që nuk besojnë në arsyen dhe në të vërtetën. Ndërsa për vlerësimin se bisedimet janë "trik politik" iu ka shkuar mendja udhëheqësve të partive të egjiptianëve dhe ashkalive, organizatave të shoqërisë civile dhe shumë të tjerëve të pa angazhuar në politikë por të ndërgjegjshëm për fatin e komunitetit tonë. Këto perceptime janë reale por nuk duhet pranuar që të jenë të arsyeshme.

Çështja e ndarjes së komunitetit në egjiptian dhe ashkali, në vitet e fundit ishte vlerësuar si fakt i kryer. Ky vlerësim u tha haptas nga ana e politikanëve, në media dhe në "libra". Çështja e nevojës së bisedimeve në mes të përfaqësuesve të komunitetit të ndarë ishte menduar nga segmente të përfaqësuar në IRDK dhe për këtë qëllim ishte iniciuar krijimi i një Forumi të Egjiptianëve i cili do të merrej ekskluzivisht me këtë çështje. Pas një kohe pritje të fillimit të funksionimit të Forumit, çështja e komunitetit të ndarë u hodh në Kuvendin zgjedhor të IRDK-së ku edhe u votua vendimi për hartimin e platformës për bisedime me komunitetin ashkali. Edhe brenda strukturave të IRDK-së dominoi inercioni lidhur me këtë çështje por procesi i inicimit të bisedimeve nuk arriti të ndalet brenda strukturave të kësaj partie. Edhe unë pajtohem me faktin që partitë politike nuk do të duhej të merreshin me këtë çështje por nuk e di se kush duhet të merret. Partitë politike nuk do të duhej të merren me këtë çështje për shkak të interesave që kanë për të zënë pozita duke mbledhur pak votave, bile një votë më shumë se rivali tjetër politik e jo më shumë. Fakti se çështja e bisedimeve në mes komunitetit të ndarë nuk sjell

edhe aq vota dhe "rrezikon" karriget e rezervuara në Parlament, dhe fakti se nuk ka mekanizma tjerë legjitim që përfaqësojnë popullin për shkak se partitë politike iu nënshtrohen votimit, atëherë duhet hequr dilemat se çështja e bisedimeve nga ana e IRDK-së është "trik politik". Madje edhe vlerësimi se kjo është një çështje e kot e IRDK-së për të arsyetuar mos punën e saj nuk qëndron sepse, për çështjen e fillimit të përafrimit të popullit, nuk ka kohë për të humbur dhe në asnjë mënyrë kjo nuk e ndal asnjërin që të kryej detyrat dhe përgjegjësit tjerë siç janë arsimimi, papunësia dhe problemet tjerë të shumta që në rrethanat aktuale nuk është aspak lehtë të zgjidhen. Se nuk është "trik politik" dhe çështje e kot qëndron fakti se gjendja aktuale e popullit të ndarë në dy ose më shumë pjesë është shumë e dhimbshme. Janë të pa përgjegjshme ato parti politike që nuk e ngritën këtë çështje, dhe në veçanti ato parti politike që eventualisht nuk do të mbështesin fillimin e bisedimeve nuk e meritojnë asnjë fije admirimi.

Vlerësimi si "mision i pa mundshëm" gjithashtu është real për momentin, por aspak i arsyeshëm. Elementi i "fortë" se "ne jemi një" qëndron mbi të gjitha vështirësitë që e kanë ndërtuar ndarjen. Nëse na prin elementi i "fortë" të gjithëve, atëherë misioni nuk është i pa mundshëm. Në mënyrë që misioni të jetë i mundshëm çka duhet dhe çka s'duhet në këtë mision. Duhet: t'i heqim dyshimet se egjiptianët dhe ashkalitë janë një, të pranojmë ekzistencën e dy entiteteve formale, të filloj menjëherë bashkëpunimi në fusha të interesit të përbashkët, t'i marrim përgjegjësitë për veprimet ose mosveprimet e duhura. Nuk duhet: të dominojnë interesat personale, të fajësohet asnjëra palë për gjendjen aktuale, të imponohet zgjidhja, të presim zgjidhje për një kohë të shkurtër. Nuk ka dyshim se misioni është i vështirë, por guximi dhe dëshira e madhe për të qenë të bashkuar, hedhin dritë në rrugën e errësuar që na shpie drejt të ardhmes së ndritur.

Për zgjedhjet e ardhshme, presidentja e Kosovës konsultohet edhe me kryetarin e IRDK-së



Me datën 02 Prill 2013, kryetari i IRDK-së Xhevdet Neziraj është pritur nga presidentja e Kosovës znj. Atifete Jahjaga. Takimi është

realizuar pas ftesës së presidentes së Kosovës për të konsultuar lidhur me datën e mbajtjes së zgjedhjeve lokale në Kosovë. IRDK si parti parlamentare është konsultuar dhe është marrë mendimi i kësaj partie lidhur me kohën e mbajtjes së zgjedhjeve. Kryetari i IRDK-së ka shprehur qëndrimin e IRDK-së që më e rëndësishmja është që këto zgjedhje të jenë demokratike dhe të mbahen në kohën që nuk tejkalon limitet ligjore dhe kushtet kohore të jenë të duhura dhe afati përgatitor të jenë i mjaftueshëm. Ky takim është shfrytëzuar për të dhënë vlerësimet lidhur me pozitën e komunitetit egjiptian në Kosovë, janë përmendur vështirësitë dhe sfidat e komunitetit egjiptian si dhe nevoja e ndërmarrjes së masave.

Kryesia e IRDK-së përshëndet arritjen e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Serbisë

Me datën 20.04.2013 në Pejë, është mbajtur takimi i rregullt i kryesisë së IRDK-së.

Në këtë takim ndër të tjera është përshëndetur arritja e marrëveshjes në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, marrëveshje kjo e cila mbështet zgjidhjen e çështjes së Veriut të Kosovës. Sipas pjesëmarrësve të takimit kjo marrëveshje do të ndikoj drejtpërdrejtë në krijimin e stabilitetit të vendit ku do të hapë perspektivë Evropiane dhe do të ndikoj në zhvillimin e vendit.

Komuniteti Egjiptian i mbështet edhe këto procese të cilat e fuqizojnë funksionalitetin e shtetit të Kosovës për ndërtimin e së cilit ka dhënë një mbështetje në të pa mohueshme në të gjitha periudhat kohore.

Po ashtu në këtë takim anëtarët e kryesisë nga degët e IRDK-së raportuan për punën dhe aktivitetet tre mujore. Ata në përgjithësi dëshmuar se aktivitet dhe veprimet e tyre i kanë realizuar në përputhje të plotë me politikat e IRDK-së dhe me planin e veprimit të miratuar në fillim të vitit 2013. Gjithashtu nga pikat tjera të rendit të ditës të cilat ishin të parapara janë mbështetur propozimet për fuqizimin e degëve



aktuale të IRDK-së në forma të ndryshme dhe krijimin e degëve të reja, degë këto të cilat shtrijnë veprimtarinë e tyre në mbrojtje dhe mbështetje të interesave të komunitetit Egjiptian në komunat ku ata jetojnë si dhe krijimin dhe fuqizimin e forumit rinor të IRDK-së të nivelit qendrorë. U propozua që takimet tjera të kryesisë të mbahen në degë tjera me kryesi të degëve jashtë Selisë së IRDK-së me qëllim të zgjerimit të debatit dhe harmonizimit e qëndrimeve të IRDK-së nga niveli qendrorë me



IRDK dhe PDAK arrijnë pajtueshmeri për fillimin e bisedimeve në mes Egjiptianëve dhe Ashkalive

Me datën 13.04.2013 në Pejë, me ftesë të Kryesisë së IRDK-së, është mbajtur takimi në mes të IRDK-së dhe PDAK-së, lidhur me mundësinë e fillimit të bisedimeve në mes komunitetit Egjiptian dhe Ashakali për përafrimin e komunitetit të ndarë. Në takim kanë marrë pjesë delegacioni i PDAK-së i prirë nga kryetari Danush Ademi me bashkëpunëtor, ndërsa ftesës nuk i janë përgjigj përfaqësuesit e PAI-së dhe LEK-ut. Delegacioni i PDAK-së është prit nga ana e kryetarit të IRDK-së Xhevdet Neziraj me bashkëpunëtor. Në takim ka qenë i pranishëm edhe Ramiz Zizaku, përfaqësues i komunitetit në Gjermani. Takimi është zhvilluar në një atmosferë shumë të relaksuar dhe pjesëmarrësit në takim i kanë

shfaqur pa rezerva opinionet e tyre lidhur me të ardhmen e komunitetit tonë të ndarë.

Pas bisedimeve dhe shkëmbimit të opinionëve, përfaqësuesit e IRDK-së dhe PDAK-së janë pajtuar për fillimin e bisedimeve lidhur me mundësinë e përafrimit të komunitetit përmes bashkëpunimit për një të ardhme të përbashkët duke eliminuar të gjitha ndasitë që na kanë përcjell në dekadën e fundit. Gjithashtu përfaqësuesit e IRDK-së dhe PDAK-së ftojnë përfaqësuesit e PAI-së, LEK-ut dhe të gjitha Organizatat Joqeveritare të komunitetit Egjiptian dhe Ashkali që të bashkëngjiten në këtë koncept të ri për hartimin e një platforme të përbashkët e cila do të shërbej për eliminimin e ndasive.

Fondi Humanitar i Egjiptianëve të Kosovës

Ju njoftojmë se është hapur xhirollogaria për grumbullimin e fondit humanitar të komunitetit Egjiptian. Xhirollogaria është nën mbikëqyrjen e Imer Alijaj, Ramadan Hasani dhe Fazli Stollaj dhe do të shërbej për të ndihmuar rastet e rënda sociale. Ju bëjmë thirrje të gjithë atyre që kanë mundësi financiare të ndajnë një pjesë të vogël nga gjepi i tyre për çdo muaj, sidomos ata që janë të punësuar në Kosovë ose diasporë, në mënyrë që të ndihmohet ata që kanë nevojë më së shumti. Ju garantojmë se të gjithë ata që do të kontribuojnë në këtë fond do të publikohen emrat e tyre në web faqet tona, dhe do të ketë transparencë të plotë lidhur me shpenzimin e mjeteve. Nëse ndani nga 10€ ose 20 € në muaj, ju do të çmoni aftësinë e juaj që iu është dhënë për të fituar, dhe pa dyshim se kjo do të iu shpërblehet me mirëqenie dhe rahat në familjet e juaja.

Kontributin e juaj mund të jepni në:

1506001003787110



IRDK e interesuar për koordinimin e veprimeve të Egjiptianëve në Ballkan



agjendën e festimit të Ditës së Egjiptianeve ku është shprehur vullneti dhe dëshira që manifestimi qendror për shtetet e Ballkanit të mbahet në Prishtinë dhe që ky manifestim të jetë sa më madhështor. Gjithashtu nga ky takim është arritur pajtueshmëri që të punohet intensivisht në të ardhmen për vetëdijesimin e gjeneratës së re lidhur me historinë e së kaluarës sonë dhe të koordinohet në gjithë faktorët e komunitetit Egjiptian në shtetet e Ballkanit për avancimin e pozitës dhe të fuqizohet më shumë shoqëria civile e komunitetit Egjiptian në Kosovë dhe rajon.

Me datën 23.04.2013, një delegacion i IRDK-së është takuar në Shkup me veprimtarin e Egjiptianëve të Ballkanit Dr. Rubin Zemon. Delegacioni i IRDK-së i përberë prej Fazli Stollaj anëtar i Kryesisë, Veton Berisha Sekretar i Përgjithshëm dhe Elbert Krasniqi anëtar i Kryesisë ka biseduar me z. Zemon lidhur me koordinimin për festimin e 24 Qershorit, Ditës së Egjiptianëve në Ballkan dhe për nevojën e koordinimit të faktorëve politik dhe të shoqërisë civile të Egjiptianëve në shtetet e rajonit për avancimin e pozitës së Egjiptianëve në këto vende. Në këtë takim është arritur pajtueshmëri lidhur me



Inciativa e Re Demokratike e Kosovës Dega në Pejë formalisht me Forumin Rinor

Prioriteti i IRDK-së dega në Pejë kanë qenë qytetaret egjiptian dhe brengat e tyre, me c'rast për gjatë muajve Mars dhe Prill të 2013 në nën-degët e partisë në Qytetin e Pejës, qytetaret shfrytëzuan mundësin që në këto takime të diskutojnë për problemet me të cilat ballafaqohen dhe të shprehin mendimin e tyre për funksionalizimin e partisë në takime me Kryetarin dhe Kryesinë e Degës. Me qëllim të koordinimit më të mirë të angazhimeve, në këto takime pos Kryesisës kanë qenë prezent edhe zyrtari komunal për Komunitete nga Zyra e Komuniteteve në Komunën e Pejës dhe përfaqësuesve të komitetit për Komunitet dhe atij për Siguri në Bashkësi. Ky takim po ashtu shërbeu që nëndegëve të ju prezantohet plani i veprimit për vitin 2013 si dhe të gjitha iniciativat e inicuar nga niveli lokal dhe qendror i IRDK-së. Mbështetje të konsiderueshme është shprehur ndaj propozimit të identifikimit të situatës në terren dhe regjistrimit intern të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian në Komunën e Pejës.

Në kuadër të iniciativës të organizimit më të mirë të strukturave partiake, me fokus të veçantë tek obligimet statutorë në takimin e Kryesisë së degës gjatë muajit Shkurt është emëruar grupi punues për organizimin e Kuvendit të Forumit Rinor të degës në Pejë. Ky grup punues është angazhuar që të identifikoj të rinjtë egjiptian të interesuar për të qenë pjesë e kuvendit të forumit rinor, me fokus të veçantë tek studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme. Pas takimeve përgatitore me të rinjtë e komunitetit egjiptian nga të gjitha bashkësitë territoriale të Pejës, me 6 Prill 2013 është mbajtur kuvendi zgjedhor i Forumit Rinor të degës në Pejë në prani të 46 Delegatesve. Në procesin zgjedhor me shumicë vota është zgjedhure për kryetar të forumit Rinor Shefqet Radovici, si dhe struktura menaxhuese është e përbërë nga katër nënkryetarë, sekretari dhe zyrtari për informim. Në këtë kuvend zgjedhor të FRIRDK-se në Pejë, pjesëmarrës ishin dhe Kryetari i Degës së Pejës, Kryetari i IRDK-së dhe Sekretari.



Të shfuqizohet Strategjia dhe të përafrohen Egjiptianët dhe Ashkalitë

Në mbledhjen e Kryesisë së IRDK-së të mbajtur me datën 17.03.2013 në Pejë, është diskutuar lidhur me komunitetin Egjiptian karshi Strategjisë së Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për mundësitë e përafrimit të komunitetit Egjiptian dhe Ashkali dhe për zhvillimet në degët e IRDK-së. Kryetari i IRDK-së, fillimisht i njoftoj anëtarët e Kryesisë lidhur me iniciativën e tij në komisionin për Komunitete në Parlamentin e Kosovës për të kërkuar vlerësim e implementimit dhe arritjeve të objektivave të Strategjisë nga ana e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim dhe partnereve tjerë implementues. Ai theksoi se kjo strategji është në rrugë e sipër për të dështuar për shkak se që nga fillimi nuk ka qenë dokument i cili ka pasqyruar nevojat reale të komunitetit egjiptian. Lidhur me këtë çështje Kryesia e IRDK-së vendosi që përmes një shkresë t'i drejtohet Qeverisë së Kosovës dhe aktereve tjerë relevant në Kosovë në të cilë shkresë do të kërkohej që Qeveria e Kosovës të zhvlerësojë dokumentin e quajtur Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015, të krijohet një fond për përkrahje të arsimimit dhe projekteve për përmirësimin e infrastrukturës në vendbanimet ku është koncentruar komuniteti egjiptian, të ndërmarren masa në zbatimin e ligjit të Shërbimit Civil dhe udhëzimeve Administrative që burojnë nga ky ligj, e që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal dhe qendror, të ndermerren masa të veçanta, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e

të drejtave të komuniteteve, për punësim në Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, FSK, Ndërmarrjet publike dhe të sigurohet qasje e barabartë me komunitetet tjera në mediumet publike të Kosovës.

Në lidhje me nevojën e përafrimit të Egjiptianëve dhe Ashkalive, pas një debati të anëtareve të Kryesisë, u vlerësua shumë e nevojshme fillimi i përafrimit të komuniteteve pavarësisht dallimeve që na kanë përcjell deri me tani. Kryesia e IRDK-së konsideron se:

- praktika për të mundur njëri tjetërin duhet të ndalet dhe në vend të kësaj duhet të filloj një epokë e re e komunitetit tonë. Tani duhet të jetë epoka e fillimit të përafrimit me njëri tjetërin.

- egjiptianët dhe ashkalitë janë i njëjti popull dhe të njëjtën gjë kërkojmë nga ana e ashkalive që të konfirmojnë.

- interesi madhor i komunitetit të ndarë në egjiptian dhe ashkali është pajtimi për fillimin e përafrimit të komunitetit përmes bashkëpunimit për një koncept të përbashkët të integrimin dhe përparimin e komunitetit në shoqëronë e Kosovës.

- të gjithë përfaqësuesit e komunitetin tonë, përmes organizatave politike dhe të shoqërisë civile në Kosovë, kanë përgjegjësi për veprimet dhe për mos veprimet e duhura, dhe nevojitet guximi i duhur për interes nacional.

Në këtë shkresë do të ftohen deputet z. Danush Ademi dhe Ethem Arifi për një takim në pjesën e parë të muajit Prill, ku do të bisedoheshin mënyrat e fillimit të përafrimit të komunitetit tonë të ndarë.

Praktika për të mundur njëri tjetërin duhet të ndalet dhe në vend të kësaj duhet të filloj një epokë e re e komunitetit tonë

Thirrje drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës, z.Danush Ademi dhe z.Ethem Arifi

Të Nderuar deputet në Parlamentin e Kosovës, z.Danush Ademi dhe z.Hetem Arifi,

Ndarja e komunitetit tonë në Egjiptian dhe Ashkali në Kosovë pas vitit 1999 është e dëmshme dhe po e dëmton seriozisht të ardhmen tonë. Vija e ndarjes është mirë që të minimizohet dhe pas një periudhe sa më të shkurtër të mos ekziston ndarja.

Ne përfaqësuesit e komunitetit, të cilët i përfaqësojmë interesat e popullit në institucionet e Kosovës, është mirë që të tregohemi të përgjegjshëm për fatin e popullit tonë dhe të zgjedhim rrugën e duhur e cila na qon në perspektivë. Në momente të caktuara, e që ndoshta edhe na kanë befesuar, kanë ndodhur zhvillime të ndryshme, e që ka qenë e vështirë të gjendet rruga e duhur. Nuk ka asnjë dyshim se personazhet e historisë sonë, të cilët dolën publikisht, që nga viti 1990 dhe pas vitit 2000, kishin për synim identitetin etnik të veçantë dhe dinjitetin e tyre sikurse popujt tjerë. Edhe personazhet e vitit 1990 të cilët publikisht deklaruan identitetin egjiptian, edhe personazhet e pas vitit 1999 të cilët deklaruan publikisht identitetin ashkali, edhe ata personazh të cilët e vazhduan publikisht me identitetin egjiptian, që të gjithë kishin për qëllim qartësimin e identitetit etnik dhe të jetuarit me dinjitetet.

Populli ynë pas viti 1999 publikisht i ka dy emra: egjiptian, që identifikon popullin tonë bazuar në origjinën, dhe ashkali bazuar në njërin prej etnionimeve për popullin tonë në rrafshin e Kosovës. Në rrethanat e pas vitit 1999, që ishin të vështira për popullin tonë, ne nuk arritëm që të arrijmë marrëveshje lidhur me identitetin tonë etnik, dhe si rezultat i kësaj pasoj ndarja formale në ligje dhe akte tjera ligjore në Kosovë.

Pas ndarjes formale, për fat të keq filloi një betejë për përfitim të masës nga ana e të dy blloqeve të ndara duke bërë përpjekje për bindje të masës

me “argumente”. Zgjedhja e kësaj rruge padyshim se ishte e gabuar sepse kjo rrugë e thelloi ndarjen dhe ndërpreu komunikimin.

Beteja për t'i kthyer egjiptianët në ashkali dhe ashkalitë në egjiptian vazhdon që 12 vite, ndërsa mendimi i arsyeshëm është tretur në fushën e polarizuar në polet egjiptian dhe ashkali dhe ende nuk po del në sipërfaqe. Arsyeja thotë se Egjiptianët dhe Ashkalitë janë i njëjti popull dhe nuk duhet të vazhdojnë të qëndrojnë të ndarë, por duhet të fillojnë menjëherë që të ofrohen njëri me tjetrin. Në pjesën e dytë të vitit të kaluar ne kishim disa takime të rëndësishme me subjektet politike dhe të shoqërisë civile të ashkalive, ku patëm mundësi që të bisedojmë rreth nevojës së fillimit të përafrimit.

Të Nderuar deputet në Parlamentin e Kosovës, z.Danush Ademi dhe z.Hetem Arifi,

- Konsiderojmë se praktika për të mundur njëri tjetrin duhet të ndalet dhe në vend të kësaj duhet të filloj një epokë e re e komunitetit tonë. Tani duhet të jetë epoka e fillimit të përafrimit me njëri tjetrin.

- Konsiderojmë se egjiptianët dhe ashkalitë janë i njëjti popull dhe të njëjtën gjë kërkojmë nga ana e juaj që të konfirmoni.

- Konsiderojmë se interesi madhor i komunitetit të ndarë në egjiptian dhe ashkali është pajtimi për fillimin e përafrimit të komunitetit përmes bashkëpunimit për një koncept të përbashkët për integrimin dhe përparimin e komunitetit tonë në shoqërinë e Kosovës.

- Konsiderojmë se të gjithë ne që përfaqësojmë komunitetin tonë, përmes organizatave politike dhe të shoqërisë civile në Kosovë, kemi përgjegjësi për veprimet dhe për mos veprimet e duhura, dhe duhet të jemi në gjëndje që të bëjmë hapa të guximshëm për interes nacional, prandaj ju ftojme që të mos na refuzoni në kërkesën tonë për një takim të përbashkët në pjesën e parë të muajit prill të këtij viti.

Të zhvlerësoni dokumentin e quajtur “Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015”



Kryesia e IRDK-së përmes një deklarate ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës që të zhvlerësoi dokumentin e quajtur “Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009 - 2015” dhe në vend të saj të merrë hapa konkret në fushën e arsimit, infrastruktures, punësimit dhe qasjes në meime publike.

Pozita e komunitetit Egjiptian në Kosovë vazhdon të jetë jo e mirë dhe pa shenja të dukshme të përmirësimit. Komuniteti Egjiptian në Kosovë është duke mos u pajtuar me pozitën reale dhe këmbëngul që ky komunitet të jetë në pozitën e duhur. Aktualisht komuniteti Egjiptian i Kosovës është në pozitë të marginalizuar, ashtu siç e kanë vlerësuar edhe organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Komuniteti egjiptian i Kosovës është pjesë e rëndësishme e shoqërisë së Kosovës dhe patjetër duhet të ketë të ardhme të përparuar në krahasim me gjendjen aktuale. Institucionet e Kosovës nuk po tregohen të përgjegjshme për përmirësimin e gjendjes aktuale të komunitetit Egjiptian në Kosovë.

Qeveria e Kosovës, ka adoptuar një dokument strategjik të quajtur “Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015”. Këtë dokument IRDK e ka kundërshtuar që në fillim dhe vazhdon të kundërshtoj edhe tani për arsye se ky dokument cenon identitetin etnik të Egjiptianëve të Kosovës dhe nuk pasqyron problemet dhe nevojat reale të komunitetit.

Duke qenë të këmbëngulës për përmirësimin e gjendjes reale të komunitetit Egjiptian të Kosovës, përmes kësaj deklarate, kërkojmë nga Qeveria e Republikës së Kosovës që menjëherë:

- Të zhvlerësoni dokumentin e quajtur “Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali, Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015”.
- Të merrni masat për ngritjen e nivelit të arsimit në të gjitha nivelet e arsimit përmes hartimit të programeve të veçanta të subvencionimit të nxënësve dhe studenteve dhe për punësimin e të diplomuarve në nivelin superior.
- Të përcaktoni një shumë të caktuar nga buxheti i Kosovës, për çdo vit, për financimin e projekteve të infrastrukturës në vendbanimet ku është i përqendruar komuniteti egjiptian.
- Të ndërmerrni masa në zbatimin e ligjit të Shërbimit Civil dhe udhëzimeve administrative që burojnë nga ky ligj, e që kanë të bëjnë me përfaqësimin e komuniteteve në nivel lokal dhe qendror
- Të ndërmerrni masa të veçanta, ashtu siç parashihet edhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të drejtave të komuniteteve, për punësim në Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, FSK dhe Ndërmarrjet publike
- Të sigurohet qasje e barabartë me komunitetet tjera në mediumet publike të Kosovës

EGJIPTIANËT KOSOVAR DHE KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Veton Berisha

Populli Egjiptian i Kosovës, i vlerësuar si një prej popujve autokton në Kosovë origjina e së cilit është nga Egjipti, tradicionalisht ka qenë pjesë e shtet-ndërtimit të Republikës së Kosovës. Pastë gjitha sfidave që kaloj historikisht komuniteti Egjiptian, tani ky i fundit do të ndihet krenar pasi që arriti të jetë i mbështetur dhe i përkujdesur nga akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës siç është Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka hyrë në fuqi me 15 Qershor 2008. Kosova para se të miratohet kjo Kushtetutë fillimisht ka pasur rezolutën 1244 të miratuar nga OKB prej së cilës janë nxjerr disa dokumente ligjore siç ishin rregulloret e UNMIK-ut dhe dokumente tjera më të vogla. Korniza Kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme e paraprirë nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/9 për një periudhë prej 6 viteve ka qenë dokumenti bazë për vetëqeverisje të Kosovës. Pas disa veprimeve politike që ndodhën në Kosovë erdhi në shprehje pakoja e Ahtisarit e vitit 2007 dokument ky i cili është inkorporuar në tërësi në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Në të gjitha këto dokumente të përmendura si dhe me ligjet e miratuara para dhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës, Populli Egjiptian i Kosovës e gëzoj statusin e grupit kombëtar ose etnik i cili ishte tradicionalisht i pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës dhe i veçuar gjithnjë nga të tjerët. Angazhimi komunitetit Egjiptian në përgjithësi sidomos të përfaqësuesve politik të IRDK-s dhe përfaqësimi si anëtar i rregullt e Kryetarit të IRDK-s z. Xhevdet Neziraj në Komisionin për hartimin e Kushtetutës me të drejta të plota, bëri që Egjiptianët e Kosovës të ndihen më komod në përfshirje të dispozitave Kushtetuese.

Në vijim do të japim një interpretim mbi dispozitat kushtetuese, aty ku komuniteti Egjiptian gjënë mbështetje të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë: Në dy paragrafët e para të Preambulës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës thuhet se: “Ne, Populli

i Kosovës, të vendosur për të ndërtuar një ardhmëri të Kosovës si një vend i lirë, demokratik dhe paqedashës, i cili do të jetë atdhe i të gjithë qytetarëve të vet; Të përkushtuar për krijimin e një shteti të qytetarëve të barabartë, i cili do të garantojë të drejtat e secilit qytetar, liritë qytetare dhe barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit”

Siç dihet Preambula është pjesa hyrëse dhe e rëndësishme e Kushtetutës me të cilin çdo shtet zotohet për formën e qeverisjes dhe zhvillimin e demokracisë në vend. Me këtë rast Republika e Kosovës zotohet se Kosova do të kujdeset në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët e saj.

Kapitulli i II-të i Kushtetutës së Republikës së Kosovës siguron mbrojtjen e dinjitetshme e të drejtave dhe lirive të njeriut të cilat i konsideron si të pandashme, të pa tjetërsueshme dhe të pacenueshme në bazë të rendit Juridik të Republikës së Kosovës. Gjithashtu ky kapitull siguron që askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personl. Në nenin 22 të këtij kapitulli, Kosova merr për obligim zbatimin e konventave ndërkombëtare, konventa këto që janë në mbrojtje të rreptë ndërkombëtare në rastet kur komunitetet pakicë diskriminohen nga shtetet përkatëse. Këto konventa janë: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj; Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; Konventa për të Drejtat e Fëmijës; Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, saj. Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Me këtë kapitull popullit Egjiptian i Kosovës i mundësohet që të jetoj dhe të zhvillohet i lirë pavarësisht bindjeve të tij fetare, kombëtare etj.

Kapitulli III- flet për të Drejtat e Komuniteteve dhe pjesëtarve të tyre. Në këtë kapitull Egjiptianët e Kosovës trajtohen si grup i njëjtë kombëtar ose etnik i cili tradicionalisht është i pranishëm në teritorin e Republikës së Kosovës, i cili do të gëzojë edhe të drejta të veqanta krahas të drejtave dhe lirive themelore për të drejtat e njeriut. Me këtë kapitull shteti i Kosovës ka për përgjegjësi që edhe me ligje të Kosovës dhe me ndarje të buxhetit të siguroj hapësirë të mjaftueshme që çdo pjeshtar i komunitetit Egjiptian lirshëm të deklarohej dhe të zhvillojë identitetin dhe atributet e tyre të vequara nga të tjerët.

Vlenë të theksohet se me nenin 58 të këtij kapitulli thuhet se Republika e Kosovës përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës ka marrë për obligim që të i mundësoj komunitetit Egjiptian dhe pjesëtarve të tyre të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre, përmes aktiviteteve ekonomike, shoqërore, politike, kulturore dhe trashëgimore dhe përdorimin e simboleve. Po ashtu Republika e Kosovës do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur personat të cilët mund t'u nënshtrohen kërcënimeve ose veprimeve diskriminuese, armiqësisë a dhunës, si rrjedhojë e identitetit të tyre kombëtar, etnik, kulturor, gjuhësor ose fetar.

Neni 60 i këtij kapitulli e themelon Këshillin Konsultativ për Komunitetet, këshillë ky i cili është nën autoritetin e zyrës së Presidentit të Republikës. Në këtë këshillë komuniteti Egjiptian është i përfaqësuar me dy anëtar. Kompetencë e së cilit është dhënja e rekomandimeve në fazat e hershme legislative dhe ndërmarrje e iniciativave për qështje që janë në interes të komuniteteve e në këtë rast të komunitetit Egjiptian. Ky Këshill është një mekanizëm për shkëmbim të rregullt të qështjeve në mes të komuniteteve dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përfaqësimi në punësim në Institucionet Publike Neni 61 i Kushtetutës e ka paraparë që komunitetet dhe pjesëtarët e tyre do të kenë të drejtë për përfaqësim të barabartë në punësim në organet publike dhe ndërmarrjet publike në të gjitha nivelet, përfshirë këtu veçanërisht në shërbimin policor në zonat e banuara me komunitetin përkatës. Kjo dispozitë i jep mundësi apo lehtësirë komunitetit Egjiptian që të ketë mundësi punësimi natyrisht duke i përmbushur kushtet përkatëse për atë vend pune. Neni 62 siguron përfaqësimin e komuniteteve në Organet e Pushtetit Lokal në ato komuna në të cilat së paku dhjetë për qind (10%) të banorëve u përkasin komuniteteve, të cilat në ato komuna nuk janë shumicë, posti i

zëvendëskryetarit për komunitete të kuvendit të komunës do të rezervohet për një përfaqësues nga radhët e këtyre komuniteteve. Postin e zëvendëskryetarit do ta mbajë kandidati që i përket popullatës që nuk është shumicë, që ka marrë shumicën e votave në listën e hapur të kandidatëve për zgjedhje për kuvendin e komunës. Kjo e drejtë natyrisht do ti takonte komunitetit Egjiptian në ato vendbanime ku janë në numër më të madh dhe do të mbështetnin partitë e komunitetit Egjiptian me votën e lirë.

Kuvendi i Kosovës me Nenin 64 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës komunitetin Egjiptian e përfshinë me një vend të garantuar i cili në rast se ka më shumë vota se komuniteti Rom dhe komuniteti Ashkali do të ketë mundësi që të e siguroj edhe vendin e dytë të përcaktuar për këto tri komunitete. Nuk përjashtohet mundësia që komuniteti Egjiptian duke e vlersuar numrin potencial të votuesve që të arrijë të ketë edhe tre deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Me këtë rast pozita politike e komunitetit Egjiptian do të fuqizohet dhe komuniteti Egjiptian do të faktorizohet. Kjo qështje mbetet në vullnetin e votuesit nëse dëshiron të e fuqizoj vetveten.

Në përgjithësi në rast se komuniteti Egjiptian do të jetë i mbështetur në mënyrë të kënaqshme nga vota qytetarit, Kushtetuta ka dhënë hapësirë të mjaftueshme që ky komunitet të përfaqësohet më tepër edhe në komisione të Kuvendit të Kosovës si mekanizëm i rendësishëm për nisma dhe mbikqyrje legislative, të përfaqësohet në kryesinë e Kuvendit, të ketë ndikim në Legjislacionin me Interes Vital për komunitetin Egjiptian, të jetë i përfaqësuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ministritë përkatëse, në shërbimin civil, në këshilla dhe borde të ndryshme, në sistem të drejtësisë, në qeverisje lokale në përgjithësi dhe në sektorin e sigurisë siç është shërbimi Inteligent, Policia e Kosovës, FSK-së, dogana dhe të ngjajshme.

Kosova konsiderohet se ka një infrastrukturë të mirë ligjore të mbështetur në politikat Evropiane që konsiderohet se si më e mira në Rajon, por në përgjithësi vërejtja ekziston tek zbatimi i saj.

Në këtë aspekt të gjithë qytetarët e Republikës Kosovës sidomos komuniteti Egjiptian i Kosovës dhe përfaqësuesit e tij të insistojnë gjithnjë në realizimin e obligimeve kushtetuese dhe ligjore nga Republika e Kosovës përkatësisht qeveria e saj.

Autori është jurist i diplomuar dhe Sekretar i Përgjithshëm i IRDK-së

Gjendja reale e komunitetit Egjiptian në Kosovë



Imer Zykollaj

Përveç vështirësive për të mbijetuar, popullata është ballafaquar me skamje e mjerim, në mungesë të kushteve elementare për jetë. Vështirësia me e madhe ka qenë përballja me asimilimin e këtij komuniteti në komunitetet tjera. Gjatë luftërave të ndryshme që kanë ndodhur në trevat ballkanike edhe ato me përmasa botërore, egjiptianet kanë qenë në shënjestër të tjerëve që ta përdorin këtë komunitet për të arritur interesat e komunitetet tjera. Mirëpo prej viteve të 50-ta të shekullit të kaluar e këndej këtyre presioneve nga tjerat komunitete ju kanë kundërvënë njerëzit tanë në këtë kohë pak të shkolluar e vitet me vonë të shkolluar dhe të mençur duke mos kursyer edhe jetët e tyre. Viti 1981 ka një rëndësi të madhe për komunitetin tonë në përgjithësi sepse filluan përpjekjet dhe tentimi për të regjistruar si egjiptian, mirëpo këto përpjekje me vullnetin e të tjerëve dështuan duke dashur që të na përvetësojnë për vete dhe na klasifikuan si të "panjohur". Mbledhja e rreth 4000 nënshkrimeve dhe nënshkrimi i peticionit iu bë e ditur organeve qeveritare të atëhershme se egjiptianet ekzistojnë dhe se janë prezent në këto hapësira. Vitet e 90-ta na sjellin formimin e shume shoqatave të ndryshme: në Ohër, Strugë, Kosovë etj. Sipas regjistrimit të vitit 1993 në Kosovë jetojnë 120.000 egjiptian. Në diasporë gjithashtu formohen shoqata të ndryshme me qëllim të mbrojtjes së identitetit etnik dhe aktivitetet e shumta rreth kësaj çështje. Pas mbarimit të luftës së fundit në Kosovë në skenën kosovare u paraqit Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës si parti politike e Egjiptianëve të Kosovës, me qëllim të mbrojtjes, promovimit dhe avancimit të qeshjes së identitetit etnik të Egjiptianëve në Kosovë. Përfaqësuesit legjitim të zgjedhur nga populli ju përveshen punës dhe arritën që pas vetes të tubojnë njerëz të arsimuar dhe të mençur që ta qojnë çështjen tonë përpara. Mendoj që me vet faktin që këta përfaqësues ju vunë në ballë të popullit dhe i vunë vetes si obligim që të punojnë dhe veprojnë për popull është një e arritur e organizuar mirë dhe me mençuri. Rezultatet nuk mungojnë është punuar në çështjet e njohjes dhe ndërkombëtarizimit të egjiptianëve në Kosovë që ka qenë prioritar tani është duke u punuar në disa drejtime mjaft të qëlluara siç është; bashkimi me pjesën tjetër të ndarë të popullit "ashkanlinjeve" në forcimin e marrëdhënieve me shtetin amë të Egjiptit, janë ven disa kontakte, gjithashtu po punohet në konsolidimin e radhëve të IRDK-s dhe përgatitjet e këtij

subjekti politik për zgjedhjet lokale në vjeshtë. Komuniteti ynë i gëzon të gjitha të drejtat të parapara me Konventat dhe dokumentet ndërkombëtare. Jemi të vetëdijshëm se komuniteti ynë po përballlet me problemet e shumta që e preokupojnë mirëpo edhe në këtë drejtim është duke u punuar që komuniteti ynë sidomos të ndihmohet në çështjen e punësimit, arsimimit të të rinjve në çështjet sociale, banesore dhe infrastrukturës. Komuniteti mbijeton fal të afërmeve të tyre në diasporë dhe burim të veten jetese është ky financim. Strategjia e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve RAE e Republikës së Kosovës 2009-2015 nuk ka sjell përmirësime në gjendjen ekonomike të popullatës, vetëm sa e ka përkeqësuar gjendjen edhe ashtu të rend të komunitetit. Edhe pas kundërshtimeve të shumta për këtë dokument nga subjekti ynë politik dhe përfaqësuesi ynë në Parlamentin e Kosovës zoti Neziraj në media të shkruara dhe elektronike disa individ të komunitetit tonë dhe të tjerë që udhëheqin OJQ-t në Kosovë po e implementojnë këtë strategji kundër vullnetit tonë e me këto veprimtari të tyre po i sjellim dëme të mëdha popullatës sonë duke i përdorur si shfrytëzues të projekteve të tyre. Disa njerëzit që i udhëheqin këto OJQ nga komuniteti ynë janë persona autodidakt të pa arsimuar mirëpo kemi edhe persona të shkolluar "analfabet me shkollë" që interesat e tyre personale i kanë vu para atyre të komunitetit. Këta persona që implementojnë strategjinë nga komuniteti ynë e kanë gjendjen e mirë ekonomike nuk kanë nevojë të merren me këtë veprimtari dhe përfitime në kurriz të popullit i cili edhe ashtu është në gjendje të rend. Shfrytëzohen fëmijët, grat, pleqtë me projektet e tyre e që qëllimi i atyre projekteve nuk arrihet as aj problem i paraparë nuk zbutet jetë vetëm në letër, donatarëve ju epen të dhëna dhe statistika që merren nga komuniteti kur vijnë donatorët fëmijët nxirren nga shkollat e rregullta i dërgojnë neper qendrat e tyre vetëm për ti par donatorët. Është e lehtë të fotografohen këta fëmijë, gra e pleq mirëpo a mendoj ndonjë herë sikur dikush ti shfrytëzonte familjet e tyre, këto familje janë të detyruara të punojnë punë të rënda dhe të bëjnë çmos për mbijetesë, fëmijët e tyre janë të zbathur pa veshmbathje e me bark bosh e fëmijët e juaj... Ju kisha apeluar të gjithë atyre që po merren me këtë veprimtari punoni ashtu si duhet të jeni humanitar të vërtetë kontribuoni për popullin tuaj mos u boni "lodra" të huaja dhe ju them se pasuria me e madhe për një njeri është ta bënë një vepër të mirë për komunitetin e vet e që në të ardhmen fëmijët tuaj të jen balle lart dhe krenar që kanë pas kesi prind, vene një gur mbi mure.

Komente dhe Qëndrimet e IRDK mbi Strategjinë për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015

Komente dhe Qëndrimet e IRDK mbi Strategjinë janë bërë në vitin 2009 si reagim i miratimit të këtij dokumenti nga ana e Qeverisë së Kosovës. IRDK nuk ka pranuar që të marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti

Hyrje

Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) është parti politike, deri me tani e vetme, e cila udhëhiqet nga egjiptianet e Kosovës dhe është e përkushtuar në mbrojtjen e interesave, promovimin e vlerave dhe avancimin e pozitës së egjiptianeve të Kosovës. IRDK është themeluar në mars të vitit 2001 dhe njeri prej qëllimeve themelore ishte mbrojtja, promovimi dhe avancimi i çështjes së identitetit etnik të Egjiptianeve të Kosovës. IRDK dhe përfaqësuesit e saj janë të vetmit përfaqësues legjitim të komunitetit egjiptian të Kosovës pasi që në të gjitha zgjedhjet e mbajtura pas vitit 2001 kanë marrë votëbesimin në nivelin lokal dhe qendror. Komuniteti egjiptian i Kosovës përfaqësohet në Kuvendin e Kosovës dhe në tri Kuvendet Komunale të Kosovës (Gjakovë, Pejë dhe Istog). Përpos mbrojtjes, promovimit dhe avancimit të çështjes së identitetit etnik të komunitetit egjiptian në Kosovë, IRDK është shumë mirë e njohur me pozitën e këtij komuniteti në shoqërinë e Kosovës. IRDK është e vetëdijshme se komuniteti egjiptian i Kosovës nuk ndodhet në pozitën e merituar në shoqërinë e Kosovës dhe ne jemi shumë të përkushtuar që ky komunitet të arrijë në pozitën meritorë në shoqërinë e Kosovës.

Ne jemi shumë mirënjohës institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për interesimin e shprehur që pozita e egjiptianeve të Kosovës të ndryshohen në mënyrë që edhe ky komunitet të jetoj me dinjitet dhe i barabartë me komunitetet tjera në Kosovë por ne i kundërshtojmë ashpër të gjitha përpjekjet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare për cenimin e identitetit etnik në emër të "integritetit" të këtij komuniteti. Strategjinë e Qeverisë së Kosovës për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015, që në fillim të hartimit të saj e ka cenuar identitetin etnik të egjiptianeve të Kosovës dhe për këtë arsye nuk kemi marrë pjesë në hartimin e këtij dokumenti. Kjo strategji tani e shpallur e përfunduar paraqet një dokument bosh i cili është i pa zbatueshëm dhe jemi plotësisht të vetëdijshëm se ky dokument do ti shërbej Qeverisë së Kosovës vetëm si arsyetim se ne kemi strategji për këto komunitete por na mungojnë vetëm fondet. Kryesia e IRDK-së e ka shqyrtuar strategjinë dhe ka vendosur që të kundërshtojnë këtë dokument përmes nënshkrimit të një peticioni.

Mangësitë e Strategjisë për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015

I. Cenimi i identitetit etnik

Edhe pse dokumenti quhet Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, kjo strategji është hartuar vetëm për një komunitet dhe vetëm simbolikisht janë cituar këto komunitete që ka ndikuar në rritjen e volumit të këtij dokumenti, ndërsa kryekëput kjo strategji i dedikohet komunitetit rom të Kosovës. Në asnjë rast në këtë dokument nuk janë theksuar veçoritë dhe dallimet në mes të këtyre komuniteteve dhe gjithmonë janë evidentuar problemet e romëve. Të gjitha shifrat dhe referencat tjera mbi gjendjen e këtyre komuniteteve janë dhënë si numri ose përqindja e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian ndërsa është dhënë një shifër e vetme duke mos qartësuar se sa janë romë sa ashkali dhe sa egjiptian (p.sh. Tabelat në faqe 8 dhe 9). Në të gjitha referencat e këtij dokumenti kinse për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian kemi vetëm një shifër, vetëm një përqindje, vetëm një masë për veprim, vetëm një konkluzion, vetëm një rekomandim dhe askund nuk gjendet diçka e ndarë për secilin komunitet. Ky dokument na thotë se:

- secili rom është edhe rom edhe ashkali edhe egjiptian
- secili ashkali është edhe rom edhe ashkali edhe egjiptian
- secili egjiptian është edhe rom edhe ashkali edhe egjiptian

Ne jemi shumë të vetëdijshëm se egjiptianet e Kosovës kanë shumë probleme të njëjta çfarë i kanë edhe romët e Kosovës ose shqiptaret e Kosovës ose boshnjaket e Kosovës etj. Ngjyra, problemet në arsim, problemet me varfëri, problemet në infrastrukturë dhe probleme tjera nuk mund të mohohen se nuk janë probleme edhe të egjiptianeve edhe të romeve edhe të ashkalive por dallimet etnike, gjuhësore, kulturore, sociale etj. në mes të romëve në njërin anë dhe egjiptianeve dhe ashkalive në anën tjetër bëjnë që këto probleme të mos zgjidhen me të njëjtin shabllon.

II. Përmbajtja e dokumentit

Përmbajtja e këtij dokumenti është deklaratë e cila përmban:

-konstatime për problemet faktike të “komuniteteve” në mënyrë jo të kompletuar

Të dhënat të cilave iu referohen gjatë konstatimit të gjendjes se “komuniteteve” janë jo burimore dhe iu referohen burimeve të organizatave ndërkombëtare si:

- o UNDP,
- o Instituti për Shoqëri të Hapur, Programi për Përkrahjen e Edukimit, Monitorimi i Edukimit të Romëve,
- o Instituti për Shoqëri të Hapur, Programi për Shëndetin Publik, Lista e Fakteve për Shëndetin Publik: Të Lënë Pas Dore: Romët dhe Qasje në Kujdesin Shëndetësor në Evropën Lindore dhe Juglindore
- o Këshillit të Evropës
- o UNHCR
- o OSCE etj.

Konstatimet për gjendjen e “komuniteteve” më së shumti janë marrë nga shënimet e UNDP dhe në një fusnotë (faqe 61) thuhet: “UNDP, Fytyrat e Varfërisë, Fytyrat e Shpresës. Bratisllavë 2005. Shumica e vendeve nuk i njohin ashkalijtë dhe egjiptasit si grupe të veçanta etnike. Prandaj, shumica e botimeve ndërkombëtare i përmendin vetëm romët, mirëpo kjo zakonisht i përfshin edhe ashkalijtë dhe egjiptasit”. Shumica e konstatimeve janë bazuar në raportet e organizatave të lartshënuara të cilat janë raporte për romët e Evropës, romët e Evropës Juglindore ose romët e regionit.

- vargun e premtimeve jo reale për zgjidhjen e problemeve

Masat e parapara për zgjidhjen e problemeve janë një varg premtimesh të cilat i përngjajnë shumë premtimeve në fushata zgjedhore, dhe është koleksion i kopjeve të strategjive për integrimin e romëve në Evropën Qendrore dhe Juglindore dhe varg i dëshirave të përpiluesve të dokumentit. Në masat e parapara në dokument për zgjidhjen e njërit prej problemeve kryesore të komunitetit egjiptian dhe komuniteteve tjera, problemin e punësimit, në një pasues thuhet se “Ministria e Financave dhe Ekonomisë në bashkëpunim me donatorët dhe institucionet relevante financiare do të zbatojë masa që inkurajojnë vetëpunësimin e familjeve rome, ashkallike dhe egjiptase.”, ndërsa askund në dokument nuk janë përmendur se cilat masa do të zbatohen për këtë problem. Ky dokument i shtron detyra Qeverisë së Kosovës duke supozuar se në Qeveri funksion gjithçka në mënyrë perfekte dhe nuk është marrë parasysh fakti se Qeveria e Kosovës ka marrë kompetencat sipas kushtetutës së Republikës së Kosovës në pjesën e dytë të vitit 2008. Dokumenti të lenë përshtypjen që e tërë Qeveria e Kosovës do të koncentrohen në zgjidhjen e problemeve të identifikuar dhe nuk është marrë parasysh fakti se problemet e identifikuar nuk janë probleme të vetëm komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian dhe fakti se pa një rritje të përgjithshme ekonomike nuk ka asnjë mundësi për zgjidhjen e shumicës së problemeve të identifikuar. Në dokument është paraparë intervenime në legjislacion, krijimi i strategjive lokale për integrimin e këtyre komuniteteve dhe krijimin e mekanizmave për implementimin e kësaj strategjie. Intervenime në legjislacion mund të behën dhe mund të krijohen mekanizma por me siguri këto mekanizma do të jenë jo funksional pasi që praktika ka treguar se mekanizmat ekzistues si Ministria për Kthim dhe Komunitete, Zyret Komunale për Komunitete, Komitetet për Komunitete janë jo funksional, edhe pse ka vite që janë krijuar, pasi që përgjegjësit për funksionimin e këtyre mekanizmave nuk janë të përkushtuar që ato të funksionojnë dhe presin që ende ato të funksionojnë përmes mekanizmave ndërkombëtar.

III. Zbatimi i strategjisë

Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015 është dokument i cili nuk është iniciuar dhe nuk është hartuar nga Qeveria e Kosovës por vetëm është përkrahur. Kjo strategji është iniciuar, financuar dhe hartuar nga KFOS, OSBE, UNDP, Këshilli i Evropës dhe lobi rom i cili vepron në Perëndim. Kontributi dhe pjesëmarrja e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian ka qenë vetëm simbolike ndërsa përfaqësuesit legjitim të komunitetit egjiptian nuk kanë marrë pjesë në hartimin e kësaj strategjie me përjashtim të ashtuquajturës shoqëri civile

e cila nuk përfaqëson komunitetin egjiptian por individët që udhëheqin këto OJQ për interesa të ngushta personale. Me gjithë të metat e dokumentit kjo strategji nuk do të zbatohet për shkak se:

✍️ Dokumenti nuk është iniciuar dhe hartuar nga Qeveria e Kosovës ndërsa pritët që të zbatohet nga Ministria për Kthim dhe Komunitete dhe siç thuhet nga Ministrinë tjera të linjës, agjensionet dhe shoqëria civile.

Pastaj është e njohur se Ministria për Kthim dhe Komunitete është njëra prej Ministrive më kaotike dhe shquhet për mos efikasitet, keqpërdorime dhe keq menaxhim. Kjo ministri e cila është vetëm simbolike për shkak të emrit të cilin e mbanë është shembulli më i keq i funksionimit të Qeverisë së Kosovës dhe me problemet e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë asnjëherë nuk është marrë

✍️ Dokumenti është strategji për integrimin e romëve pasi që aty shtjellohen problemet që përmbajnë vetëm specifikat e romëve. IRDK do të mbështetë në praktikë zbatimin e kësaj strategjie vetëm si strategji për integrimin e romëve por jo edhe të egjiptianeve, për shkak se IRDK konsideron se egjiptianët nuk mund të integrohen duke u shndërruar në rom. IRDK nuk është kundër integrimit të romëve se solidarizohet në zgjidhjen e problemeve të tyre.

Qëndrimet e IRDK-së lidhur me Strategjinë për Integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në Republikën e Kosovës 2009-2015

1. Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptianë në Republikën e Kosovës 2009-2015 cenon ashpër identitetin etnik të Egjiptianeve të Kosovës.
2. Përmbajtja e strategjisë nuk parasheh integrimin e tri komuniteteve me specifika të veçanta por integrimin e tri komuniteteve që nuk dallohen nga njëra tjetra.
3. Për zgjidhjen e të gjitha problemeve të identifikuarra për tri komunitetet parashihet një shabllon.
4. Strategjia është model i strategjive për integrimin e romëve në shtetet e Evropiane (Çeki, Sllovaki, Rumani etj.) dhe nuk përputhet me specifikat e komuniteteve, për të cilat është hartuar kjo strategji.
5. Strategjia nuk do të zbatohet shkak se:
 - o përmbajtja e saj është komplekse dhe abstrakte
 - o nuk është iniciuar dhe hartuar nga institucionet që pritet të zbatojnë
 - o në 6 vitet e ardhshme Qeveria e Kosovës, e cila duhet zbatuar këtë dokument, do të ballafaqohet me shtet ndërtimin prandaj nuk do të jetë prioriteti integrimi i këtyre komuniteteve
6. IRDK e konsideron këtë dokument si Strategji për integrimin e komunitetit Romëve në Republikën e Kosovës 2009-2015
7. IRDK i rekomandon Qeverisë së Kosovës që për komunitetin egjiptian të Kosovës në 6 vitet e ardhshme duhet të ndërmarr këto masa konkrete:
 - 1) Të sigurojë për çdo vit masa lehtësuese për pranimin e studenteve dhe nxënësve të shkollave të mesme të komunitetit egjiptian të cilët konkurrojnë në Universitetet dhe shkollat e mesme publike në Kosovë
 - 2) Të ndajë për çdo vit nga 50 bursa për studentet egjiptian më të dalluar të Universitetit publik dhe 200 bursa për nxënësit egjiptian më të dalluar të shkollave të mesme publike.
 - 3) Të punësoj për çdo vit nga 20 pjesëtarë të komunitetit egjiptian me përgatitje superiore dhe të mesme në cilësinë e shërbyesve civil
 - 4) Të punësoj për çdo vit nga 15 pjesëtar të komunitetit egjiptian me përgatitje superiore dhe të mesme në ndërmarrjet publike: 5 veta në PTK, 5 në KEK, 2 në Aeroportin e Prishtinës dhe 3 në Ndërmarrjet Publike Lokale të cilat ofrojnë shërbime të ujit të pijes dhe pastrimit.
 - 5) Të punësoj për çdo vit nga 5 pjesëtar të komunitetit egjiptian me përgatitje superiore dhe të mesme në dogana dhe 5 pjesëtar të komunitetit egjiptian me përgatitje superiore dhe të mesme në Policinë e Kosovës
 - 6) Të subvencionoj 5 ndërmarrje private për çdo vit për punësimin e 5 pjesëtareve të komunitetit egjiptian, me kohëzgjatje prej 24 muajve, të cilët posa i kanë përfunduar studimet në Universitetin Publik ose jashtë vendit
 - 7) Të shtroj për çdo vit nga 5 km asfalt në vendbanimet ku është i koncentruar komuniteti egjiptian
 - 8) Të ndërtoj për çdo vit nga 3 km kanalizim në vendbanimet ku është i koncentruar komuniteti egjiptian
 - 9) Të ndërtoj për çdo vit nga 5 km ujësjellës në vendbanimet ku është i koncentruar komuniteti egjiptian
 - 10) Të ndërtoj për çdo vit nga 5 trafostacione në vendbanimet ku është i koncentruar komuniteti egjiptian
 - 11) Të krijohen lehtësira për legalizimin e vendbanimeve jo formale në të cilat janë koncentruar komuniteti egjiptian.
 - 12) Të krijohet fondi i Qeverisë së Kosovës për ndërtimin e shtëpive dhe infrastrukturës përcjellëse për të gjithë ata që dëbohen me forcë nga Perëndimi e të cilët i kanë shtëpitë e rrënuara dhe të asistohen këto familje me nga 100 € në muaj në kohëzgjatje prej 1 viti.
8. IRDK i rekomandon Qeverisë së Republikës së Kosovës që për komunitetin egjiptian Strategjia për integrimin e komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian të mos zbatohet fare por në vend të saj të zbatohen masat e përshkruara në pikën 7.

Historia e Egjiptianëve të Ballkanit

Prof.Dr.Rubin Zemon

Çështja e identitetit, etno-kulturës dhe historisë të egjiptianëve të Ballkanit është një nga problemet më të vështira shkencore. Duke e kujtuar se historia nuk është çështje e të kaluarës, por është përgjigje e nevojave të jetës moderne, është gjithashtu e rëndësishme të gjendet mënyra, se si një kontekst historik ose tradicional përdoret në procesin aktual të krijimit të realitetit. Ne do të bëjmë përpjekjen e parë për të krijuar historinë e egjiptianëve të Ballkanit duke përdorur disa fakte dhe të gjetura historike, arkeologjike dhe shkencore.

Deri në mes të mileniumit të dytë para Krishtit në Mediteranin jugorë, vendi dhe civilizimi i Egjiptit antik ka pasur ndikim dhe fuqi të madhe. Nga shekulli i XII para Krishtit përdorimi i bronzit në ekonomi filloi të zëvendësohet nga përdorimi i hekurit. Fillimi i kohës së hekurit dhe “revolucionit të hekurit” në mënyrë periodike përkoj me të ashtuquajturën Dinastinë XIX në Egjipt, ose Faraonit Sethi I (1294-1279 p.e.r) dhe Ramezesi II (1279-1213 para Krishtit) [2]. Pasi që ata ishin më të interesuar të përdorin hekurin, këta faraon filluan të importojnë hekurin nga vendet afër Egjiptit por edhe nga vendet më në distancë si Anadolia, Veriu i Apenineve, Qipro, Peloponezi etj.

Sipas legjendës, Kadmus e ka pasur një motër të quajtur evropë e cila ishte kidnapuar nga Zeusi. Në kërkim të evropës, Kadmus ka udhëtuar së pari në Kretë dhe më vonë në pjesën kontinentale të Greqisë moderne dhe përmes Ohrit shkoi në bregdetin Adriatik i cili është në Malin e Zi të sotëm. Legjenda e Kadmosit dhe gruas së tij Harmonisë ka lidhje me tokën egjiptiane (Teba në Nil), Teba në Beotia (Greqi) dhe përfundimisht me Tebë në bregdetin Adriatik (që sot quhet Tivat). Shumica e emrave nga trashëgimtarët e Kadmosit janë të njëjta me ato vendeve historike dhe emrat epaf, djali i Zeusit, dhe ai u martua me Memfisën, vajzën e Nilit. Ata kishin një vajzë të quajtur Libia (emër grek për Afrikën). Libia ishte gjyshja e Kadmosit, evropës dhe Belit. Beli ishte babai i Danajës (Hellas) dhe Ajgipës (egjiptit). Një prej fëmijëve të Kadmosit quhej Ilir. Me anë të transformimit Zeusi në dem (Apes një prej Zotërve Dem ishte zot në mitologjinë Egjiptit) dhe kujton lidhjen me perëndeshën gjarpër egjiptian Uazit (në variacionin Helenik “Budue”, që mund të ndërlidhet me qytetin malazez Budva në Detin Adriatik), ne mund të marrim me mend fuqinë e civilizimit egjiptian, në mitin dhe legjendën e Kadmosit. Lëvizjet migruese të egjiptianëve mund të vërehen në të gjitha këto të dhëna.

Revolucioni i hekurit, hulumtimi dhe eksportimi i rezervave të hekurit, është ndoshta një prej arsyeve pse faraoni Ramezesi II [III. 3] luftoi dhe pushtoi lindjen e bregdetit Mediteran dhe në Gadishullin Ballkanik, për të cilin sundim kemi dëshimi nga Herodoti [III. 4]. Nga tekstet e Herodotit, ne mund të shohim se në kohërat e lashta tek Greket dhe te popujt ballkanas, dihej se kishte njerëz me origjinë nga Egjipti që jetonin në fqinjësi. Kolonizimi i Egjiptianëve në territorin e Ballkanit të dikurshëm mund të tregohet me tragjeditë antike greke, siç janë “Furnizuesit” nga Eskili (Aeschylus). Ne gjithashtu gjejmë shenja të kolonizimit egjiptian në mitologjinë antike, si psh., “Miti për Kadmosin dhe Harmoninë”. Kur flasim për mitologjinë antike, tregon besimin në origjinën e njerëzve antik nga Aleksandri i Madh, baba i vërtetë i të cilit ishte Faraoni Naktareb.II (Nakhtharheb). Sipas disa burimeve të lashta besohet se ai ishte babai i vërtetë i Aleksandrit të Madh, gjatë vizitës së Olimpias, nënës së Aleksandrit, gjatë mungesës së shpeshtë të Philipit II, edhe Olimpia edhe Aleksandri preferuan të quajnë perandorin Egjiptian Amon si babai i Aleksandrit. [III. 5]. Arkeologjia dëshmon ekzistimin e njerëzve me origjinë nga Ballkani, gjithashtu. Shumë tempuj të Izida dhe mbretër të tjerë egjiptian janë ruajtur nëpër Ballkan, por më të famshmet janë tempujt e Izida në Ohër [III.8] dhe Heraklea (Manastir) [III. 9]. Gjithashtu mund të vërehet edhe në stilit e bubuzhelit (skarabejt- një insekt i shenjtë në mitologjinë egjiptiane) të popujve ballkanas. Kultet egjiptiane dhe monumentet e tyre ishin tejet të pranishme në Gadishullin Ballkanik gjatë kohës së Perandorisë Romake. Disa nga monumentet janë sjellë nga legjionarët romak, nga zyrtarët e ndryshëm apo nga shërbëtorët mirëpo, egjiptologu kroat Petar Selem deklaroi se në këtë kohë në Ballkan mund të gjejmë egjiptian të asimiluar në mesin e Qytetarëve nëpër kolonitë provinciale dhe nëpër komuna si skllav apo qytetarë të lirë si dhe egjiptian që nuk janë asimiluar dhe që nuk pranojnë trajtat helenike dhe romake të zotërave të tyre dhe që mundohen të i mbajnë monumentet e tyre në gjuhën e tyre amtare egjiptiane, por që janë në një pozitë shoqërore të përjashtuar. Kjo situatë është karakteristike për “egjiptianët” në Solana (afër Splitit) dhe afër ishujve që i përkisnin klasave të ulëta dhe që ishin mbase tregtar të vegjël apo zanatlinj. Kjo popullatë ishte e izoluar, e mbyllur brenda qarqeve të tyre etnike dhe profesionale dhe që kultivonte atdheun e tyre në format origjinale të zotërave të tyre.



Simbioza e së ashtu quajturës kulturë helenike, religjionit krishtere dhe modelit romak të ndërtimit të shtetit, qoi tek krijimi i fenomenit historik të quajtur Perandoria Bizantine. Duke pasur parasysh se me Ediktin të Milanos në vitin 313 pas Krishtit, me të cilën religjioni i krishterë u bë një religjion legal dhe i vetmi religjion në perandori, kishat patën një ndikim të madh tek njerëzit në perandori dhe në jetën politike. Këshillat e mëdha të Kishave mbajtën debate për çështjet e vështira të religjionit dhe për konfliktet edhe pse, pati shumë konflikte politike me pasoja të rënda dhe afatgjate. Në vitin 431 pas Krishtit, Këshilli i Kishës u mbajt në Efesus dhe kishat Aleksandriane morën rolin prijës në mesin e kishave. Por, kundër lidhësve të kishave Aleksandriane u bashkuan episkopitë e Konstantinopolit dhe Romës. Në vitin 451 pas Krishtit, u mbajt Këshilli i katërt i përgjithshëm.

Këshilli i Kalqedonit refuzoi idenë se Krishti kishte vetëm një natyrë dhe deklaroi se Krishti kishte dy natyra në një person të vetëm. Dogma Kalqedoniane përshkruan “tërë njerëzinë dhe tërë hyjninë” e Krishtit, personin e dytë të Trinitës së shenjtë. Këshilli po ashtu përpiloi edhe 27 kanunet disiplinore për qeverisjen e administratës së kishës dhe autoritetin e kishës [III. 11]. Në periudhën pas Këshillit kishtar Kalqedonian kishte mungesë të të dhënave historike dhe të tjera që tregojnë për popullatën e Ballkanit me origjinë nga Egjipti p.sh. regjistri i vendbanimeve në perandorinë Bizantine që është përgatitur nga Stefani i Bizantinit në shekullin e V pas Krishtit, ku përmendet Egjipti dhe Egjipti i vogël si regjione të perandorisë. Por në letrat e Teofilaktit nga Ohri [III.12], Kryepeshkopi i kishës së Ohrit aty kah fundi i shekullit të XI dhe në fillim të shekullit të XII, gjenden të dhëna historike që kanë lidhje me egjiptianët e Ballkanit.

Kryesisht, në letrat e destinuara për Nikolaj Anema, ai shkruante se “hegjemonistit” ishin: kryebashkiaku (Castroctist), Kapiteni dhe “ndihmësi i tretë, i cili sipas emrit, është sikurse të ishte faraoni”. Sipas historianëve “faraoni” qeveriste si një “Strateg” në regjionin e “Ohrit dhe Pellagonisë”, dhe ndoshta këto organe qeverisëse udhëhiqeshin nga njerëzit me origjinë jo greke. Kryepeshkopi Teofilakt kishte shumë telashe nga “faraoni” që mund të shihet nga një letër që ai shkroi pasi që “faraoni” u zëvendësua puna e tij u përmirësua shumë. Po ashtu në një letër nga Teofilakti dërguar Taronitullit (“Duka i Shkupit”), përmendet një “egjiptian” që e ka mashtruar atë. Në një letër tjetër që i është shkruar episkopit të Kerkiras, Teofilakti shkruan: “...për tërë këtë, më duhet të shkoj te Cari, që do të thotë më duhet të shkoj përmes detit (haridba) ose të shkoj përmes Egjiptit, një udhëtim shumë vështirë”. Duke pasur parasysh se Teofilakti ishte në Ohër dhe i duhej të udhëtonte te Cari në Konstantinopol ai do të preferonte një rrugë për tokë përmes Manastirit dhe Selanikut që ishte rruga më e shkurtë.

Nga kjo letër mund të supozojmë se ka pasur një rrugë nëpër tokë nga Ohri deri në Konstantinopol si pjesë e rrugës së vjetër romake Via Egnatia, e cila ishte e populluar me një numër të madh të Egjiptianëve dhe për këtë arsye Teofilakti simbolikisht shkroi se i duhej të udhëtonte “përmes Egjiptit në një udhëtim të vështirë”. Në interpretimet e burimeve historike të shekullit XIII dhe XIV nga shkencë moderne e sotme, mund të hasim në shumë konfuzione, me nocione të pacaktuara dhe në dallime të paqarta. Ky fenomen vjen si identifikim i romëve, me origjinë nga India veri-perëndimore si “egjiptian”. Duke pasur parasysh se romët ishin të përjashtuar nga shoqëritë ballkanike dhe evropiane edhe në atë kohë, disa nga romët dhe disa nga fiset e tyre preferonin të paraqiteshin si “egjiptian” për një prestigj më të lartë në shoqëri, duke fshehur origjinën e tyre indiane. Për arsye të kësaj “mimikrie etnike” qasja ndaj burimeve historike nga kjo periudhë, duhet të jetë shumë sensitive dhe përfundimet duhet të bëhen me shumë kujdes, posaçërisht kur caktohen dallimet ndërmjet romëve dhe komunitetit egjiptian të Ballkanit kur në burimet historike ata përmenden si “egjiptian”. Në dokumentet e patriarkut të Konstantinopolit Gregori i II Qiprioti, (1283-1289), përmendet një tatim i posaçëm që është mbledhur nga të “ashtuquajturit egjiptianët dhe ciganët”, si dhe përvojat me rastin e mbledhjes së këtyre tatimeve.

Në praktikumin e manastirit të Ksiropotama në Athos, viti 1325-1330, është e shënuar se Ana, bija e Limocervulit kishte një burrë “egjiptian”. Po ashtu, në tokën e manastirit Larva jetonte “egjiptiani Nikolaus”. Në disa dokumente nga 5 nëntori i vitit 1362 nga arkiva e Dubrovnikut, Vllaho dhe Vitani përmenden si “egjiptian” që u kërkohet nga gjykata (një anëtarë i quajtur Raden Bratoslaviq) ti kthejnë tetë rrypa të mëdhenj argjendi.

Në versionin bullgar të biografisë së Shën Barbarosit nga shekulli i XIV, që ka jetuar në shekullin e IX përmenden një numër i madh i “Egjiptianëve”, që jetonin në bregdetin e Durrësit. Ngatërrimi më i madh në interpretimin e burimeve historike është i lidhur me vendbanimin e quajtur “Egjipti i vogël”. Një numër i madh i dijetarëve mendojnë se “Egjipti i vogël” ka qenë në Peleponez ndërkaq ekzistojnë hipoteza që e vendosin këtë vendbanim ose në Izmir ose në Anthiohia. Interpretimet lidhur me “Egjiptin e vogël” thonë se aty jetonin romët: “...kryesisht një popullatë e varfër; burrat kryesisht ishin të njohur si farkëtarë por merreshin edhe me mbarimin e këpucëve dhe me arnime Von Harf kishte informata se popullata rome erdhi në “Egjiptin e vogël” nga një vend i quajtur Gupe Dzipi, 50 kilometra nga Modonia që është rreth 120 kilometra nga Naflio...” siç mund ta shohim nga shembujt më lart, ka deklarime të qarta dhe përshkrime të qarta të individëve si “egjiptian”; disa dijetarë i kanë klasifikuar ata si rom, duke i shikuar burimet historike me një distancë prej gjashtë shekujve! Këta dijetarë të arsimuar në kornizën e modelit të ashtuquajtur arian, ndërtuan një hipotezë pa asnjë argument të fortë dhe se deklarimi i njerëzve në mesjetë si “egjiptian” është bërë nga valët e ndryshme të migrameve të romëve. Vala e parë

e migrimeve përmes Azisë së Vogël, Bullgarisë, Serbisë, Vllahisë dhe Moldavisë; në valën e dytë nga Egjipti ose “Egjipti i Vogël” njerëzit deklaroheshin si “egjiptian” dhe ishin nga Peleponezi, Shqipëria, IRJ e Maqedonisë, Kosova, Mali i Zi dhe Dalmacia dhe përgjatë rrugëtimit ata e humbën gjuhën e tyre rome? Si do që të jetë, ndaj këtyre burimeve historike nëse kemi një qasje kulturore dhe antropologjike dhe ndoshta gjërat do të bëhen më të qarta. Është e njohur që romët në shekullin XII dhe XIV kanë jetuar një jetë endacake.

Ndikimet në asimilimin e gjuhës dhe kulturës ose madje edhe në antrponominë e popujve endacak, janë pothuaj të pamundshme. Këto procese janë tipare të popujve joendacak. Për këtë arsye, shumica e burimeve historike të përmendura më lart kanë të bëjnë me popullatën egjiptiane të Ballkanit, siç janë banorët e manastireve në Ksiropotama dhe Lavra, ku shihet qartë se ata punon si bujq. Çështja në dokumentet ku Vllaho dhe Vitani përmenden në arkivin e Dubrovnikut nga viti 1362, tregon qartë se bëhet fjalë për një joendacak të asimiluar dhe për vendësit, sepse emrat e tyre kanë një etimologji sllave ose aromaniane/vllahe. Një numër i madh i “Egjiptianëve” në zonën e Durrësit që kanë mund të flasin me Shën Barbarosin në shekullin e IX nuk mund të ndërlidhen me popullatën rome, që në territorin e Shqipërisë së sotme kanë ardhur disa shekuj më vonë.

Regjioni “Gupe Dzipi” që përmendet si toponim, që në mënyrë të drejtpërdrejt tregon në drejtim të Egjiptit, e bënë të qartë se fjala është për popullatën egjiptiane sepse të arrish një verifikim topografik është proces i gjatë me shekuj. Në anën tjetër, ne përmendem se “Egjipti i Vogël” përmendet edhe në Regjistrin e vendbanimeve të Perandorisë Bizantine, i përgatitur nga Stefani i Bizantinit në shekullin e V. Nëse e pranojmë teorinë se “Egjipti i Vogël” gjendet në Pelepones, atëherë shënimet e Herodit për origjinën e liderëve të Dorianit, tregojnë qartazi lashtësinë e farkëtarëve nga “Grupe Dzipi”. Natyrisht ne nuk mund të injorojmë hipotezën se popullata rome ka migruar në Pelepones në shekullin e XIV dhe më vonë u shpërnda legjendae Kontëve nga “Egjipti i Vogël” për një prestigj më të madh në shoqërinë perëndimore evropiane.

Deklarimi i preferuar si “egjiptian” nga romët në shekujt XIII-XV ka pasoja të mëdha në përzierjen e Egjiptianëve të Ballkanit me romët dhe me këtë vije edhe deri tek ngatërrimi. Ky ngatërrim është prezent dhe mund të gjendet në dokumentet e Perandorisë otomane. Otomanët i kanë identifikuar romët si Kopt ose “kibtijan” edhe legjislaturën shtetërore si në rastin: “Defeteri-i mufassal-i esam-i mahsulat ve mersumat-i Kibti-yan-i vilayet-i Rum-ili ki der efkaf-i merhumve magfur sulat Bayazid Han..., ve efkaf ve emlak-i vuzera-i izam ve umera-i kiram ve Luva-i Kibtiyan ve zuamave erbab-i timar vaki'side est”, prej vitit 1522/1523. Edhe Sulltan Sulejmani i Mardhërishmi, në vitin 1530 proklamoi “Kanunname-i Kibti-yani i vilaet-i Rumeli” dhe në vitin 1541 „Kanun-i ser' asker- i Liva-i Cingane”. Madje edhe nga i njëjti sulltan dy emra të ndryshëm etnik përdoren në dy dokumente të ndryshme (“kib-tiyani” dhe “Cingane”). Duke lexuar tekstin, është e qartë se legjislatori nuk ka bërë dallime etnike dhe normat e legjisacionit kanë të bëjnë me popullatën endacake.

Për arsye të mënyrës endacake të jetës, popullata rome kurrë nuk janë të ndërlidhur për tokë apo me ndonjë spahi (zotëruesi feudal i tokave) dhe në raste shumë të rralla ka rom që janë rajë ose bujq. Në pjesën e parë të shekullit të XIX, nën presionin e fuqive të mëdha të asaj kohe në Evropë, Perandoria Otomane filloi të bëjë disa reformat të sistemit politik, në kuptimin e respektimit të drejtave të njeriut. Në vitin 1839 u shpall Hatisherifi i Gylhanit me garancione për barazi të plotë para ligjit për të gjithë qytetarët, së bashku me sigurinë dhe nderin për popullin. Këto të drejta u zgjeruan me Hatihumijaumin në vitin 1856, me garancione për barazinë e religjioneve, të drejtën për religjion dhe vetëdije, gjykata të përziera, të drejtë për krishterët për të marrë pozita publike dhe të shërbejnë në armatë dhe të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këshillin e shtetit. Në këtë kontekst ligjor dhe politik, më 3 korrik 1867 në një gazetë “Maqedonia” që publikohet në Stamboll e gjejmë një letër, e nënshkruar nga “një egjiptian”. Përmbajtja e letrës është për diskriminim racor ndaj Egjiptianëve në perandori dhe për rolin e “kishës greke” në përjashtimin e Egjiptianëve nga të drejtat fetare. Kjo letër e publikuar, është një dokument i vlefshëm për identitetin egjiptian dhe për vetëdijesimin egjiptian në gjysmën e dytë të shekullit të XIX.

Në fund të shekullit të XVIII dhe në fillim të shekullit të XIX procesi i zhvillimit të kombeve moderne filloi në mesin e kombësive të ndryshme në Ballkan. Me këtë sistem, ndarja sipas religjionit u bë shumë më pak mundshme. Ky proces njihet si rilindje kombëtare. Posa u formuan shtetet e pavarura në shekullin e XIX, filloi një konflikt i hapur ndërmjet tyre. Për secilin grup etnik, besnikëria ndaj grupit vinte në rend të parë dhe besnikëria ndaj shtetit se ku jetonin deri atëherë, vinte në vendin e dytë, nëse kishte diçka të tillë. Koncepti perëndimor (dhe imperial) i besnikërisë ndaj shtetit pa marrë parasysh origjinën etnike, fetare etj, ishte i çuditshëm tek popujt ballkanas, duke pasur mungesë të precedentit të duhur historikë në kushtet ekzistuese. Kjo çoi deri te shumë luftëra, ngritje dhe konflikte ushtarake. Luftërat ballkanike 1912-1913, Lufta e parë botërore ndërmjet viteve 1914-1919, lufta greko-turke 1920-23, lufta e dytë botërore, 1939-1945 (1941-44 në Ballkan) ishin konflikte kryesisht etnike të natyrës së lartë përmendur, p.sh. okupimet italiane dhe gjermane.

Në këtë kontekst politik, në shtetet e Ballkanit, egjiptianët e Ballkanit nuk ia dolën të gjejnë “vendin nën diell” për identitetin e tyre dhe për të drejtat e tyre kolektive në ndonjë shtet të Ballkanit. Ata përsëri u bënë viktimë të asimilimit, shkrirjes dhe përvetësimit. Duke pas parasysh mbrojtjen e pakët që ata kishin si popull mysliman, ata fshihnin identitetin e tyre etnik, deklarorin identitetin e tyre fetarë dhe në shumicën e rasteve identifikoheshin si “Turq”. Ata që i takonin fesë katolike u “shkrinë” totalisht brenda grupit dominues të shumicës në vendin ku ndodheshin. Megjithatë, mund të vërehet shkëputja individuale pa ndonjë rezultat, siç është vënë re në gazetën “Vecerna posta” (“Posta e mbrëmjes”) nga 20 dhjetori 1905 me artikullin “Ne jemi kopt, kemi ardhur nga Egjipti”. Situata në shtete të Ballkanit është ndryshuar krejtësisht pas luftës së dytë botërore dhe adoptimit të Deklaratës Universale të drejtave universale të njeriut 1948, si dhe të kapitujve dhe konventave të tjera. E drejta për lirinë e identitetit, të fjalës, publikimit, fesë, bindjes politike dhe e drejta për të protestuar kanë filluar të respektohen. Përpjekjet për deklaratën dhe njohjen e identitetit egjiptian janë vënë re në Shqipëri (1945), Bullgari (1955) dhe Kosovë (1961), por pa ndonjë vetorganizim serioz ose reagim.

Procesi i prezantimit publik të identitetit të Egjiptianëve doli në shesh në vitin 1970 me përpjekjen e parë për të pasur kodeks/graftë të veçantë për “egjiptianët” në regjistrimin në ish Jugosllavi dhe në ish republikën jugosllave të Maqedonisë në veçanti. Lëvizja egjiptiane pranoi një shtytje pas kushtetutës së RSFJ të vitit 1974 (Art. 166, 170) ku krijoj të drejtën për çdo qytetar të deklarojë identitetin e tij etnik. Disa egjiptian e mbajnë në mend se në regjistrimin e përgjithshëm në vitin 1981 disa nga ata kanë deklaruar vetën si “gjup ci”, por u klasifikuan si “Romë”. Të tjerët deklaruan vetën si “Egipqani” (egjiptian) për herë të parë në “ish republikën Jugosllave të Maqedonisë”, por nuk u regjistruan në rezultatet e përgjithshme të regjistrimit dhe u klasifikuan si të “panjohur”. U bë e qartë se pa pasur një regjistrim të qartë të përgjithshëm (për egjiptianët) ekzistenca e tyre nuk do të bëhet e njohur publikisht. Me qëllim që të arrijnë këtë kodeks/graftë të veçantë egjiptiane, njerëzit filluan të qarkullojnë peticione në “ish republikën Jugosllave të Maqedonisë” dhe në Kosovë (afërsisht rreth 4000 njerëz nënshkruan peticionin në Kosovë. Këto peticione u ishin dërguar niveleve të ndryshme qeveritare. Përpjekja për të krijuar një komunitet të veçantë udhëhiqej nga asociacionet e reja, së pari në “ish republikën Jugosllave të Maqedonisë” dhe më vonë edhe në Ballkan. Në vitin 1990 shoqata “Egjiptianët” në Jugosllavi u themelua nga Nazim Arifi si kryetar dhe seli në Ohër. [III. 15]. “Shoqata e Egjiptianëve të Kosovës” u themelua më 21 tetor të vitit 1990 me kryetar Vesel Kadroli. Në të njëjtën kohë, klubi egjiptian u themelua në Beograd dhe më vonë kjo u zgjerua në Unionin të Egjiptianëve “Esnafe”.

Në vitin 1991, në Strugë, u themelua partia politike e Egjiptianëve, Partia e Lëvizjes Demokratike e udhëhequr nga Napoleon Kamberi. Pas fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë më 1991, bazuar në organizatat ekzistuese të egjiptianëve në Jugosllavi, shoqata të pavarura u themeluan në “ish republikën Jugosllave të Maqedonisë” dhe Serbi. Në vitin 1992 udhëheqës i shoqatës së Egjiptianëve ishte Usni Zemoski ndërsa Nazmi Arifi mbeti kryetar nderi. Në të njëjtën kohë ideja e identitetit të veçantë egjiptian ishte shtrirë përtej kufijve të ish Jugosllavisë dhe shoqata të ngjashme u formuan edhe në territorin e Shqipërisë nga “Evgjitët”. E para u themelua në Korçë më 28 qershor 1992. U përcoll nga shoqatat rajonale si shoqata kulturo-arsimore “Orient” në Vlorë, shoqata e studenteve egjiptian në Shqipëri, që më vonë u bashkua në shoqatën kulturore të Egjiptianëve të Shqipërisë “Nefreta” (psh. Nefertiti), e regjistruar më 22 Mars, 1993 me kryetar Behar Sadikun. Në vitin 1992 u themelua komiteti i shqiptareve egjiptian që më vonë u bë “Partia për barazi, dinjtet dhe të drejta [III. 17]. Në vitin 1998 në mënyrë zyrtare u bashkuan shoqata të ndryshme dhe, në kongresin e Ohrit, u prezantua formimi i Unionit të Egjiptianëve të Ballkanit. Në kongres morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha organizatave ekzistuese të egjiptianëve nga “ish republika Jugosllave e Maqedonisë”, Shqipëria dhe Serbia. Rubin Zemon nga “ish republika Jugosllave e Maqedonisë” u zgjodh kryetar i Unionit të Egjiptianëve të Ballkanit dhe Behar Sadiku nga Shqipëria u zgjodh nënkryetar. [III. 18]. Paralelisht nga ky fenomen kishte përpjekje të Egjiptianëve për formimin e mediave të tyre. Në vitin 1995 shoqata e egjiptianëve jugosllav për Kosovën filloi të publikoj revistën “Zëri i Egjiptianëve jugosllav” dhe në vitin 1998 shoqata e Egjiptianëve në “ish republikën Jugosllave të Maqedonisë” filloi të publikoj revistën “Zëri i Egjiptianëve në Maqedoni”. Në vitin 1993, shoqata e Egjiptianëve ka kryer regjistrimin e saj në Kosovë. Sipas këtij regjistrimi u shënuan rreth 120,000 egjiptian në Kosovë. Përfaqësuesi i Egjiptianëve në negociatat e Rambujes dhe Parisit ishte Qerim Abazi [III. 16]. Emigrantët egjiptian të Ballkanit në Evropën Perëndimore me vendqëndrim themeluan shoqatën e tyre në Mulheim-an-der-Ruhr, në Gjermani, me kryetar Robertina Ashouri. Ekzistojnë shumë organizata të Egjiptianëve nga Kosovë në Gjermani, Zvicër, Holandë dhe Suedi, [III. 19]. Pas konfliktit në Kosovë të viti 1999 dhe vendosjes së administratës ndërkombëtare, u formuan disa OJQ të reja egjiptiane.

Faktor më i rëndësishëm i egjiptianëve në Kosovë është partia politike Iniciative e re Demokratike e Kosovës (IRDK) Bislim Hoti [III. 21] ishte kryetari i parë i partisë. Ai gjithashtu u bë anëtar i parë i parlamentit nga komuniteti egjiptian. Nga viti 2007 Xhevdet Neziraj [III. 22] u zgjodh kryetar i IRDK-së dhe u bë deputet i Egjiptianëve në Parlamentin e Kosovës. Me miratimin e ligjit për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Serbi, në maj të vitit 2006 Këshilli Kombëtar për pakicën kombëtare egjiptiane u regjistra dhe Osman Seladi [III. 20] u zgjodh kryetar. Këshilli ishte nën mbikëqyrjen e Ministrisë për të drejtat njerëzore dhe minoritete dhe financohet nga shteti.

Nënshkruesit e Deklaratës për përcaktimin e Ditës së Egjiptianëve në Kosovë



Armend Behluli



Bajram Imeraj



Bedri Mustafa



Beslim Hoti



Besnik Luboja



Ekrem Abazi



Elbert Krasniqi



Fazli Stollaj



Gazmend Dervishi



Imer Zykollaj



Imer Alijaj



Jahir Zymeraj



Milazim Alijaj



Mirjeta Gecaj



Nevruz Tafoshi

Gjatë dizajnit të numrit të kaluar, pa qëllim është harruar të vendosen fotografitë e nënshkruesve të Deklaratës z.Ekrem Abazi dhe z.Sadedin Delija të ciëve iu kërkoj ndjesë publikisht.



Ramadan Hasani



Rubin Zemon



Sadri Alaj



Sadudin Delija



Ukë Dollci



Xhevdet Gavrani



Design: Fazli Stollaj, ing
 email: info@irdk-kosova.org
www.irdk-kosova.org
www.facebook.com/irdk.kosove
 Prill, 2013